

## **Subjekti Floros SHPK**

### **VENDNDODHJA: BUSHAT , SHKODER**

#### **AKTIVITETI: PERPUNIME MERMERI**

#### **Pershkrim i Punes dhe Proceseve**

Ne ushtrimin e aktivitetit te vet kryhen keto procese pune

- Prerje e lastrave kryesisht te mermerit dhe granitit nepermjet sharres ne copa me permasa sipas porosive te klienteve
- Berje zmuso e copave te mermerit ose graniteve pas prerjes
- Lucidim te copave te mermerit
- Komplet punimi i varreve -konstruksione kryesisht mermeri-graniti
- Shitje aksesore mermeri , aksesore varresh,shkallesh etj

Perpunim i fotove tek pjeset e mermerit te varreve ose ne korniza mermeri

#### **• Lista e makinerive**

- Makineri (sharre) prerje me uje
- Makineri per zmuso
- Makineri per lucidim
- Fleksibla per prerje 1 cope
- Trapana 2 cope
- Depozite uji 500 Liter
- Kompresor ajri 1000 litra

Lenda e pare: Blloqe ne format mermeri te prere te vendit dhe te importit. Madhesia, perberja granulometrike dhe ngjyra do te jene te ndryshme dhe natyrisht format kolorite te ndryshme: gri, gri ne bezhe, bezhe e hapur, gri e erret, etj. Pllaka mermeri e granite 2. 5x1. 5m, me trashesi 10 deri 30mm

Formatet masive te mermerit, pllakat e mermerit, te granitive, me dimesione te medha (2. 5x1. 5m, 2x2m etj. ) dhe me trashesi te caktuar si dhe gurit dekorative me permasa dhe forem te crregullt. Sillen ne objekt me automjete perkatese dhe depozitohen ne sheshin para godines, duke u vendosur kryesisht ne kembe nepermjet konstruksioneve te pershtateshme metalike. Ketu, shkarkohen me

Vinc dhe mandej levizen me mjete te tjera ngritese dhe vendosen mbi bangon e prerjes te sharrave diskore.

Disqet prerese, te cilet jane te perbere sipas shkalles se fortesise me aliazhe dhe lidhjesh metalike shume te forta, vihet ne levizje me ane te elektromotoreve. Gjate procesit te prerjeve krijohen pluhura mermeri, te cilat menjehere lagen, per te mos lejuar daljen e tyre ne mjedisin e punes. Per kete qellim ne zonen e prerjes hidhet uji, i cili sherben ne te njejten kohe edhe per ftohjen e tehut prerese te diskut te prerjes.

Uji, me pluhurat e tretur ne te, derdhet ne siperfaqen e pllakes se mermerit dhe te bangos se prerjes ,ai kalon ne kanalet e brendeshme qe percjellin jashte ne vasken ku qendron uji, e cila eshte e ndare ne seksione.Ne seksionin e fundit, nje pompe centrifugale e qarkullon ujin e paster perseri per ne sharren e prerjes. Ky uji eshte normalisht i paster dhe pa permbajtje te demshme pervec prezences se ciflave te vogla te mermerit nga procesi i prerjes por qe nuk ndikojne ne procesin e prerjes se mermerit

Llumrat e mermerit, te dekantuar, tashme ne seksionin e vecante te vaskes qe mban ujin, perdoret si aditivte nga subjekti qe ben punime artizanale me mermer te natyrave te ndryshme. Ate pelqehen me shume per punime decorative mermeri . Per kete arsye mund te themi qe nga ky process nuk kemi mbetje pasi cdo gje arrin te rifutet ne procesin e vete prodhimit.

Mbas prerje se formative te medhenje ne fleta ose pllaka mermeri me permasa relativisht te medha kalojne ne makinerite e lucidimit te cilat do te marrin shkelqimin e kerkuar dhe paraqitjen dekorative.

Mbas prerjes se copave ne permasat e caktuara dhe te kerkuara, ate vendosen mbi nje bango tjeter ku ju behet rumbullakosja e buzeve te prerjes ose dhe ndonje punim tjeter i thjeshte, qe eshte kerkuar nga klientela. Per kete qellim perdoret guret zmerilo zmusuese.

Pra theksojme edhe nje here se lenda e pare jane format masive te mermerit dhe te granitit me permasa 2. 5x1. 5m, 2mx2m etj. ,sipas tregut, dhe me trashesi tashme te perfunduar, qe varion nga 10 deri ne 30 milimetra e me shume sipas kerkesave. Kete sigurohen direkt nga importi ose edhe brenda vendit.

Lendet ndihmese:

- Energjia elektrike dhe
- Uji teknologjik
- 

Energjia elektrike:

Merret nga rrjeti ekzistues, qe furnizon gjithë zonen. Fuqia e instaluar, perfshi ndricimin, arrin deri ne 50 kw. Brenda ne godinen, ku jane instaluar makinerite dhe paisjet, gjendet nje panel tjetër elektrik me kapacitet te mjaftueshem, i paisur me sistemin e leshimit dhe te mbrojtjes.

Uji teknologjik:

Uji merret edhe nga pusi i shpuar , I cili eshte shume I vjeter dhe ekzistues dhe I vetdeklaruar nga subjekti. Pavaresisht se uji rifutet ne process, nuk kemi harxhim te madh te ujit pasi sistemi eshte I tille qe rifutet serish dhe here pas here kur bie nivelit I ujit ne seksionine fundit te vaskes plotesohet me ujin e pusit.

Konsumi i ujit eshte rreth 1000 litra ne dite mesatarisht, duke patur parasysh rikuperimin e tij ne gropen e dekantimit dhe riqarkullimin ne nyjen e prerjes dhe mbas asaj dekantuese.

### **Sigurimi teknik gjate proceseve te punes**

Gjate proceseve te punes per punime mermeri si prerja,lustrimi,ngarkimi,shkarkimi e te tjera duhet te zbatohet me korektesi rregullorja e teknikes se sigurimit te punjesve.Specialistet te jene te pajisur me veshje pune e mjete mbrojtese dhe te trajtohen me antidote kur perdoren lende -solucione ngjites,hollues etj .Ne territorin ku kryhen punime dhe cila eshte radha e kryrjes se tyre.Prane repartit te jete nje kuti e ndihmes se shpejte,punetoret duhet te instruktohen